



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M  
nr. 305, datë 14.02.2014**

**“Për  
ndryshime në vendimin e KK nr. 300, datë 06.12.2013 “Për hapjen e  
procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të  
mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet  
e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |   |         |             |             |
|---|---------|-------------|-------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar     |
| • | Rezana  | KONOMI      | Zv/Kryetare |
| • | Servete | GRUDA       | Anëtar      |
| • | Koço    | BROKA       | Anëtar      |
| • | Iva     | ZAJMI       | Anëtar      |

Në mbledhjen e tij të datës 14.02. 2014, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm nr.16/1 datë 13/02/2014 dhe informacionit mbi monitorimin e realizuar në tregun e sigurimeve ;

**Baza ligjore:**Nenet 4, pika 1, 24, germa d, 41, pika 1, 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshtë Ligji.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

Relacionit Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin e realizuar në tregun e sigurimeve” nr.16/1 datë 13/02/2014 dhe informacionin mbi monitorimin e realizuar në tregun e sigurimeve nr. 16 prot datë 12.02.2014.

**VËREN SE :**

1. Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 297, datë 18.11.2013 është vendosur “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e

sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

2. Me vendimin Vendimi nr. 300, date 06.12.2013 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 291, datë 18.11.2013 “Mbi hapjen e procedurës se hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta” është zgjatur periudha hetimore deri më datë 17.01.2014.
3. Sekretariati ka dorëzuar raportin e hetimit paraprak me relacionin shoqërues të Sekretares së Përgjithshme i cili është në fazën e diskutimeve brenda Komisionit të Konkurrencës.
4. Gjatë kësaj periudhe Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë me shkresën nr. 453 prot të datës 12/02/2014 ka kërkuar nga institucionet AMF, Autoriteti i Konkurrencës dhe Ministri i Financave një reagim të menjëhershëm dhe shpjegim me shkrim lidhur me zhvillimet e fundit në tregun e sigurimeve të detyrueshme.
5. Ndërkohë ka patur një shqetësim publik në media duke filluar nga shkrimi i datës 12.02.2014 ne portalin ne rrjet mapo.al te revistës Mapo“*Fluturojnë’ tarifat e sigurimeve të makinave, nga dje 210 mijë lekë*”. Pas marrjes së kësaj indicie ne lidhje me një rritje te primeve te policave te sigurimit te MTPL-se, në datë 12.02.2014 inspektorët e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar realizuan një monitorim në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
6. Nga monitorimi rezultoi se primet e aplikuara janë rritur në të njëjtën kohë nga të gjitha shoqëritë e sigurimit në të gjitha kategoritë e këtij lloji police sigurimi në një masë të përafërt për kategoritë përkatëse.
7. Duke marrë parasysh që në bazë të Ligjit nr. 10455, datë 21.7.2011 Për disa ndryshime në ligjin nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Nenin 10, pika 2 “shoqëritë e sigurimit i përcaktojnë vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, rritja dhe fiksimi i çmimeve nga të gjitha kompanitë e sigurimit 9 shoqëri në mënyrë të menjëhershme dhe në të njëjtin nivel mund të ketë ardhur si pasojë e një marrëveshje të ndaluar në formën e sjelljes së koordinuar e cila mund të përbëjë shkelje të nenit 4, pika 1, germa a të Ligjit Nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

